Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur, KSHPK-ja (në tekstin e mëtejshëm) në seancën së 91-të, të mbajtur më 31.08.2023, morri vendimin vijues:

*VENDIM*

Denoncimi i regjistruar me numër 12-3068/1 të datës 27.06.2023, kundër televizionit kombëtar --------- dhe personit fizik ------------, **HIDHET POSHT.**

KSHPK-ja ka konstatuar se sipas Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë .

Lënda me numër 12-3068/1 të datës 27.06.2023 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

*Arsyetim*

Nga një parashtrues i njohur më 27.06.2023, është dorëzuar denoncim kundër televizionit kombëtar ---------- dhe personit fizik ---------------- dhe është formuar lënda me numër 12-3068/1 të datës 27.06.2023.

Në denoncim parashtruesi thekson se parashtron nismë në KSHPK me qëllim të marrjes së lejes së imitimit televiziv në televizionin kombëtar ------------.

Është theksuar se ky televizion e ka personin juridik ----------- i cili duke e keqpërdorur televizionin e përmendur ka kryer presion për nevoja biznesi dhe arritje fitimi.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja konstatoi se në rastin pretendimet e denoncuara nuk kanë të bëjnë me korrupsion dhe konflikt të interesit pas së cilës vlerësoi se nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë.

Në bazë të së theksuarës më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitë të këtij Vendimi.

Përgatiti: M.r K.Z
Miratoi: N.B

KOMISIONI SHTETËROR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
Nënkryetar,
Sofka Pejovska Dojçinovska

______________________________

Адреса: ул. Пресвета Богородица број 3, 1000 Скопје - Република Северна Македонија
Adresa: rr. Presveta Bogorodica nr.3, 1000 Shkup - Republika e Maqedonisë së Veriut
email: contact@dksk.org.mk
тел/tel: +389 2 3248 930
https://www.dksk.mk